

Dog Coaching Center

Tiranë, Shqipëri

[www.dogcoachingcenter.com](http://www.dogcoachingcenter.com)

Trajnerët:

**Kornelia KOKONA**

**Arbër TËRVOLI**




---

# Mësimi i kafazit të trajnimit

## Një guidë për pronarët

---



Qentë kanë natyralisht nevojë për një strofull dhe në botën moderne ku ata ndajnë ambientet me ne, kjo strofull mund të jetë shumë mirë kafazi i trajnimit. Ky kafaz mund të jetë në çdo pozicion të shtëpisë, për sa kohë ju ia prezantoni atë qenit si një ambient i sigurt dhe i qetë, njësoj sic është shtrati ynë për ne.

### **Benefitet e përdorimit të kafazit të trajnimit:**

- Parandalimi i sjelljeve shkatërruese në shtëpi.
- Parandalimi ose rehabilitimi i ankthit të ndarjes.
- Parandalimi i "sjelljeve të rojes" siç janë lehja tek dera / dritarja kur ka zhurma të huaja.
- Mësimi i kryerjes së nevojave jashtë shtëpisë.
- Vendosja dhe qartësimi i kufijve të lejuar në shtëpi.
- Përbushja e nevojave për pushim apo kompresim të energjive.
- Krijimi i një hapësire ku qeni mund të shkojë sa herë kërkon të ndihet më i sigurtë.
- E përgatit qenin për emergjenca mjekësore apo udhëtime të gjata ku do ti duhet të pushojë në kafaz.



## **Pika kyçe për tu mbajtur mend gjatë përdorimit të kafazit të trajnimit:**

- Gjithmonë jepi vëmendje dhe shpërble një gjendje të qetë psikologjike tek qeni. Ata kanë tendencë të përsërisin më shumë sjelljet të cilat shpërblehen nga ne. Nëse: qeni është duke lehur në kafaz -> ne shkojmë dhe hapim derën -> qeni pushon apo ne e nxjerrim nga kafazi, atëherë kjo i mëson qenin që është më e lehtë të marri vëmendje dhe shpërblim sa herë që leh apo tregon sjellje ekzaltuese. Por nëse ne injorojmë lehjen dhe afrohemi për të hapur derën e kafazit pasi qeni ka pushuar së lehuri, është ulur / shtrirë, atëherë qeni kupton që një energji më e ulët dhe e qetë është ajo që ne shpërblejmë dhe i japim vëmendje.
- Eshte ideale që bashkë me një gjendje psikologjike të qetë ne të kërkojmë edhe kontaktin me sy nga qeni kur e nxjerrim nga kafazi, por kur jemi duke e mësuar mund të mjaftohemi vetëm me gjendjen psikologjike të qetë në momentet e para që e nxjerrim. Gjendje psikologjike e qetë mund të vërehet kur qeni zgjedh të ulet apo edhe më mirë të shtrihet vetë, pa i berë ne presion me trup apo litar dhe sidomos pa i praktikuar komanda të cilat ia kemi mësuar më parë. Qentë nuk ulen ose shtrihen nëse janë të stresuar dhe të pasigurt për ambjentin që i rrethon. Nëse ndiqni hapat e instruktura në këtë e-book qeni do ta kuptojë lehtë që kjo është një hapësirë që mund të ndihet i qetë dhe do ulet shpejt. Sfidë për disa qen mund të jetë pritja e momentit që ata shtrihen. Nga ai moment do e keni shumë më të lehtë pjesën tjetër të punës, sepse qeni ju ka dhënë shenjën që është komod në këtë hapësirë.
- Mos i shpejtoni hapat dhe mos u stresoni nëse qeni juaj e ka të vështirë procesin që po mundoheni t'i mësoni. Ata e kanë shumë të lehtë të dallojnë momentet që ne stresohemi edhe nëse përpiqemi ta fshehim. Energjitë tona transmetohen dhe pasqyrohen në sjelljet e tyre, kështu që mbani një qëndrim pozitiv ndaj çdo gjëje të re që provoni me qenin tuaj. Askush nuk do donte të drejtohej nga dikush i pasigurt për atë që po ben.
- Nëse sot është dita e parë që do t'i mësoni kafazin qenit tuaj ju sugjerojmë që ta nisni gjatë ditës, që në mbrëmje qeni të ketë krijuar një lidhje pozitive dhe ta ketë të lehtë të flejë aty.

- Gjithmonë bëni një shëtitje para se të praktikoni kafazin për të ndihmuar qenin të heqi energjitë e tepërta. Është shumë e vështirë ti kërkojë një qeni plot me energji të jetë i qetë.
- Mund t'i jepni vaktet qenit tuaj në kafaz. Kjo do ta ndihmonte të përforconte idenë që gjëra të mira ndodhin brenda në kafaz. Gjithashtu qentë të cilët janë të frikësuar dhe hane shumë ngadalë, kanë tendencë të hanë më shpejt në kafaz duke qenë se aty ndihen më të sigurtë.
- Për këlyshët dhe qentë e rinj nuk do të rekomandonim të linit një tas uji brenda. Duke përdorur ujë shpesh mund të kërkojnë të urinojnë më shpesh seç duhet gjatë ditës por edhe gjatë natës.
- Madhësia e kafazit duhet të jetë mjaftueshëm sa për të nxënë qenin tuaj shtrirë, e lartë sa ai të qëndrojë ulur pa prekur tavanin e kafazit dhe e gjerë sa për ti lejuar të rrotullohet lirshëm.
- Ndërkohë që jeni duke praktikuar kafazin, do të përdorni vetëm një fjalë për të markuar veprimin e qenit kur sapo futet në kafaz (përshembull: Brenda) dhe vetëm një fjalë për të markuar momentin që e ftoni për të dalë jashtë kafazit (përshembull: Hajde). Cdo fjalë tjetër apo e përsëritur është e tepërt dhe vetëm do ta pengonte qenin të fokusohet dhe të jetë i qetë.



## **Hapat e mësimi të kafazit të trajnimit:**

- 1.** Vendosini një litar qenit dhe ecni rreth e qark kafazit duke e lejuar që ta nuhasi. Ky veprim e ndihmon të desentizohet me pamjen dhe aromën e kafazit pa u futur brenda.
- 2.** Hapini të dyja dyert e kafazit dhe drejtoje qenin që të hyjë nga njëra derë për të dalë tek tjetra. Fillimisht vetëm duke shkelur, pa ndaluar për të qëndruar brenda në kafaz. Përdorni presion konstant dhe të lehtë me litar vetëm sa për ta drejtuar e inkurajuar qenin që të futet brenda kafazit e të dali nga dera tjetër. Përsërite këtë hap derisa të mos të të duhet fare presion për ta drejtuar nga njëra derë tek tjetra. Disa qen mund të kenë një eksperience jo të mirë përpara këtij ushtrimi me kafazin, prandaj mund tju duhet dhe ta përsërisni shumë herë këtë hap. Qentë do ta kuptojnë çfarë ju kërkoni vetëm nëse jeni konsistent me veprimet tuaja.
- 3.** Tani mbyllni njëren nga dyert dhe drejtojeni qenin me litar për tu futur e për të dalë nga e njëjta derë qe hyn. Përsëriteni këtë hap deri kur të mos ju duhet presion litari për ta drejtuar qenin brenda.
- 4.** Filloni të markoni me fjalën "Brenda" apo "Futu" në momentet që qeni shkel brenda kafazit. Ne e kemi të lehtë të përdorim termin "Crate" për qentë tanë (në anglisht emri i Kafaz Trajnimi). Kur qeni është brenda vendosni një kufi tek dera e kafazit duke përdorur trupin tuaj apo duke shtyrë derën e kafazit si mburojë para-mbrapa në rast se është e nevojshme për ta ndaluar fizikisht. Përdor "Hajde" ne momentin e parë që të bën kontakt me sy ose thjesht ftoje me dorë për të dalë. Vazhdo përsërite me të njëjtat hapa. Qëllimi i këtij hapi është që t'i mësoni qenit që kontaktoni me sy e nxjerr nga kufiri i kafazit.
- 5.** Vazhdoni ushtrimin duke pritur që qeni të ulet dhe ta ftoni për ta nxjerrë në momentin kur ju sheh në sy. Ulja është një shenjë që qeni është më i relaksuar dhe komod me situatën seç ishte një hap më parë. Përsëriteni disa herë si hap në mënyrë që qeni të kuptojë se ju do ta nxirrni nga kafazi vetëm kur është i qetë dhe ju bën kontakt me sy.
- 6.** Shtoni kohëzgjatjen nga momenti që qeni qëndron ulur në kafaz duke pritur deri kur ai të shtrihet. Filloni prisni për kontakt me sy nga momenti që shtrihet dhe ta ftoni për të dalë. Vazhdoni përsërisni të njëjtat hapat duke pritur që qeni të shtrihet dhe ta ftoni pas kontaktit me sy. Nëse qeni është shumë i stresuar apo frikësuar, mund ta nxirrni edhe vetëm kur është shtrirë, pa pritur për kontakt me sy.

**7.** Me derën hapur filloni krijoni distancë duke u zhvendosur disa hapa mbrapa dhe duke rritur kështu kohëzgjatjen e qëndrimit shtrirë në kafaz. Nëse qeni ngrihet për të dalë, përdorni presion hapësirë për ta kthyer përsëri në gjëndje qetësie (presion hapësirë është bërja e hapave drejt tij apo përdorimi i derës së kafazit para-mbrapa si mburojë).

**8.** Punoni me këtë pjesë duke u munduar që të zgjasni kohën në momentet që qeni është i relaksuar dhe distancën tuaj nga kafazi ndërkohë që dera është ende hapur.


**9.** Mbylleni derën vetëm kur qeni është tërësisht i relaksuar pas këtyre hapave, pra të jetë shtrirë. Nëse qeni ngrihet nga pozicioni shtrirë, teksa ju po mbyllni derën, qëndroni aty deri kur ai të shtrihet përsëri. Nëse ju duket se qeni e ka të vështirë këtë hap, rikthehuni tek hapi 6 dhe përsëriteni disa herë. Do e dalloni që është koha për të vazhduar kur qeni futet dhe shtrihet menjëherë.

**10.** Rrisni kohëzgjatjen e qëndrimit të qenit me derën mbyllur dhe distancën nga kafazi (në të njëjtën dhomë) me derën me shulat e mbyllur.

**11.** Ndërkohë që qeni është i relaksuar me derën mbyllur (shtrirë, pa kuitur apo lehur) është momenti ta ftoni për të dalë. Nëse qeni ekzaltohet me afrimin tuaj drejt kafazit (ngrihet, leh, kuit, etj) ndaloni dhe prisni deri kur ai të relaksohet përsëri në mënyrë që të vazhdoni drejt kafazit për të hapur derën. Në këtë mënyrë do t'i mësoni qenit që një gjëndje psikologjike e qetë është ajo që e lejon të dali nga kafazi, dhe jo lehja apo ekzaltimi. Në varësi të qenit, mund të ndryshojë kohëzgjatja dhe distanca e largimit nga kafazi teksa po i mësoni qenit se ajo që kërkoni prej tij në kafaz është qetësia.

**11.** Vazhdoni përsëriteni si ushtrim në mënyrë që të rrisni kohëzgjatjen por edhe distancën tuaj nga kafazi.

**12.** Mbylleni këtë ushtrim duke e ftuar qenin të dali nga kafazi në një moment që qeni është në një gjëndje psikologjike të qetë dhe ju jep kontakt me sy. Do tju ndihmonte shumë për herën tjetër nëse mbyllja e kësaj eksperiencë do të ishte pozitive.



**Dog Coaching Center**

Tiranë, Shqipëri

[www.dogcoachingcenter.com](http://www.dogcoachingcenter.com)

Trajnerët:

**Kornelia KOKONA**

**Arbër TËRVOLI**

